

EDUARD SHEHI

Instituti i Arkeologjisë / Akademia e Shkencave e Shqipërisë
eduardshehi@hotmail.com

**DISA ASPEKTE TË STRUKTURËS ADMINISTRATIVE TË
DURRËSIT SI BASHKËSI QYTETARE DHE NËN TOPIAJT****Abstrakt:**

Artikulli trajton aspekte të strukturës administrative të Durrësit mesjetar. Identifikohet koncepti i dekarrike si njësi bazë e organizimit territorial qytetas, i ngjashëm me disa qytete italiane. Për çdo dekarri duhej të kishte 2 përfaqësues, dëshmuar nga një Këshill i të 12-ve. "Topothésia" lidhet me traditën bizantine, përdorur për administrimin e territorit bujqësor të kultivuar. Si drejtues i pushtetit ekzekutiv përmendet Rectori dyrachij. Përgjatë qeverisjes së Topiajve hasim tri pozicione ushtarake: kapiten; kështjellar; komestabël. Në dy dokumente hasim protovestiaris, me traditë bizantine, dhe komunitetin durrsak. Topiajt duhet të kenë ruajtur pozicionet e ulëta për mbarëvajtjen e punëve të përditshme, por kanë eliminuar postet e larta, duke përqendruar pushtetin te baronët pranë feudalit. Me kalimin e Durrësit nën Venedikun, përdorimi i sistemit të administrimit me qeveritarë venedikas të zgjedhur zhdukur përfundimisht sistemin komunal të drejtimit të qytetit.

Fjalë kyçe:

Durrësi mesjetar, sistem qeverisës, dekarri, topothesi, rektor, Këshilli i të 12-ve.

Studimet mbi periudhën mesjetare në Shqipëri kanë cekur një sërë aspektesh, por kanë lënë paksa në hije problematikat e lidhura me strukturat administrative të kontrollit të territorit apo të njërive qeverisëse. Kjo mangësi vihet re edhe në historinë mesjetare të Durrësit, pavarësisht se bëhet fjalë për qendrën kryesore urbane të Shqipërisë mesjetare. Në këtë artikull synojmë të trajtojmë disa aspekte të kësaj

problematike, për të ndihmuar sadopak në shtimin e njohurive tona.¹ Fatkeqësisht të dhënat arkivore janë shumë të pakta për të njohur pozicionet e funksionarëve, detyrat e tyre dhe detaje të tjera administrative. Për më tepër, moszbulimi i statusit të komunës qytetare të Durrësit përbën një vështirësi serioze në këtë drejtim. Në vazhdim do të bazohemi tek ato pak dokumente që njihen duke i krahasuar me të dhëna të ngjashme nga rajoni, për të paraqitur disa elemente strukturore të ndarjes administrative të Durrësit si dhe pak pozicione civile e ushtarake.

Dekarkia si njësia bazë e administrimit të qytetit dhe përfaqësimi në Këshillin qytetar

Një element me shumë interes në studimin mbi kontrollin e territorit qytetas të Durrësit lidhet me sistemin e dekarhive. Deri më sot kam arritur të identifikoj vetëm dy dokumente, përkatësisht të viteve 1246 dhe 1338, ku përmenden këto njësi administrative të qytetit. Në të dyja rastet përmendja e dekarhive është identifikuar në akte noteriale shitjeje pronash. Identifikimi i pronës në dekarhinë përkatëse dhe shënimi i saj në aktin noterial na dëshmon për ligjshmërinë e konceptit dhe funksionimin e këtij modeli, së paku nga viti 1246 deri në vitin 1338. Në zyrën e administratës së qytetit ku ruheshin dokumentet e lidhura me pronat e paluajtshme, një model kadastrë mesjetare, duhej të kishte një kategorizim të pronave në bazë të dekarhisë ku ato gjendeshin. Më pas, brenda secilës dekarhi kalohej në ndarjet e tjera zonale, për të cilat nuk është ende e qartë se si funksiononin.

Në dokumentin e vitit 1246 hasim dekarhinë “Πόρτα το Καβαλλάρι”² (Pórta to Kavallári). Ndërsa në aktin noterial të vitit 1338 “δεκαρχίαν... Θαλασσίας Πόρτας”³ (dekarhían ... Thalasiás Pórtas). Ajo që

¹ Këtë tematikë e kemi trajtuar shkurtimisht më herët në: Eduard Shehi, *Topografia e Durrësit mesjetar*, ASA, Instituti i Arkeologjisë (Tiranë: 2022), 414-427. Këtu po e rishikojmë me bibliografi më të pasur dhe me synim të veçantë kushtuar vetëm aspekteve të administrimit të qytetit.

² Lajos Thalloczy, Constantin Jireček, *Acta et Diplomata res Albaniae Mediae Aetatis Illustrantia*, Annos 344-1343, Vol. I (Vindobona: Typis Adolphi Holzhausen, 1913) (më tej: *AAIb I*), 181.

³ Gastone Breccia, Antonio Rigo, “Una carta privata greca da Durazzo (giugno 1338)”, në *Albania. Immagini e documenti dalla Biblioteca Nazionale Marciana e dalle collezioni del Museo Correr di Venezia* (Tirana: Istituto Italiano di Cultura, 1998), 68-74.

vihet re që në shikim të parë është fakti se në të vetmet raste të njohura deri më tani ku jepet dekarkia si një ndarje administrative, lidhet me dy portat kryesore të Durrësit, si elemente të rëndësishme për jetën e qytetit.⁴ Ky term ka pasur kuptime të ndryshme që nga Antikiteti deri në Mesjetë. Në vazhdim po përmendim vetë tri momente kryesore të konceptit dekarkik që kanë lidhje kohore me kronologjinë e dokumenteve tona.

Në Perandorinë Bizantine me dekarki përkufizohej një njësi ushtarake, me funksion mbrojtjeje, por edhe administrative, e cila kishte si detyrë kontrollin e hyrjeve në qytet ose vjeljen e taksave doganore.⁵ Sipas F. Lazzaro-s, i cili bën i pari një analizë të gjerë të termit, dekarkia bizantine nuk ka përfaqësuar kurrë një identitet territorial, por njësia ushtarake merrte edhe funksione administrative.⁶

Termi dekarki përcaktonte ndarjet territoriale fshatare në Korfuzin e shek. XIV-XV. Dokumenti më i hershëm i përmendjes së tij i takon një krisobule të despotit të Epirit Mihali II (afërsisht në vitin 1236) lidhur me privilegjet e klerit në zonën fshatare, duke përkufizuar kështu edhe një kongregacion fetar.⁷ Ai përsëritet në vitin 1383, kur ishulli ishte nën administrimin e Karlit III të Durrësit.⁸ Në regjistrimet venedikase të vitit 1446 të taksave feudale mbi pronën termi dekarki rishfaqet përsëri. Nga dokumentacioni i analizuar nga studiuesit mbi Korfuzin del se dekarkitë ishin ndarje administrative, grupime fiskale dhe kongregacion fetar (i përbërë nga 33 klerikë të privilegjuar të territorit rural).⁹ Origjina e një organizimi të tillë duket se lidhet me kohën e sundimit venedikas. Territori i Korfuzit gjatë periudhës së administrimit venedikas në vitet

⁴ Shehi, *Topografia e Durrësit*, 290-296, 303-307.

⁵ Bruno Paradisi, "Decarchia bizantina e decena longobarda", në *Studi di Storia e Diritto in onore di Federico Besta*, vol. II (Milano: A. Giufre, 1939), 235-264.

⁶ Franco Lazzaro, "La decarchia medievale, innovazione o persistenza?", *Annali del Lazio Meridionale*, Anno IX/2, n. 30 (2009), 18.

⁷ C. Daphnis, *Εργα*, Corfu 1959, 89-106 (Erga), cituar në Catherine Asdracha, Spyros Asdrachas, "Les paysans dans les fiefs de Corfou: XIVe-XVe siècle", në *Eupsychia: Mélanges offerts à Hélène Ahrweiler* (Paris: Sorbone, 1998), 17, cit. nr. 3.

⁸ Nicola Barone, *Notizie storiche tratte dai registri di cancelleria di re Carlo III di Durazzo* (Naples: 1887), 23-24.

⁹ C. Asdracha & S. Asdrachas, "Les paysans dans les fiefs", 17, cit. nr. 2.

1206-1213 u nda në dhjetë zona, të cilat iu dhanë si feude 10 qytetarëve venedikas, me të drejtë trashëgimie.¹⁰

Termi dekarki gjendet edhe në Italinë e Jugut, në Campagna dhe Marittima (qytetet Sezze, Alatri, Velletri, Anagni).¹¹ Te këto qytete që nga fillimi i shek. XIII e deri në mesin e këtij shekulli, ky term haset si përcaktues i ndarjeve urbane qytetare. Këto territore ishin nën juridiksionin e drejtpërdrejtë papnor.¹² Mund të ketë pasur një reformë administrative fetare, e cila futi ndarjen territoriale të dioqezave në dekarki, zbatuar kjo në hapësirën e Perandorisë së re Latine të Lindjes, nën egidën kuriale, rreth vitit 1212.¹³

Në qytetet italiane ky sistem funksiononte me përzgjedhjen e *boni homines*, nga dy për secilën dekarki qytetare. Duke përzgjedhur çdo dekarki përfaqësuesit e vet, numri i banesave që përfshinte secila, duhej të ishte i ngjashëm.¹⁴ Në Sezze qeverisnin 12 veta si përfaqësues të gjashtë dekarkive, që përmblihdnin 996 shtëpitë e komunës. Shtrirja territoriale e tyre ndryshonte me kalimin e kohës dhe, sipas zhvillimit që merrte qyteti, zonat e ndryshme mund të kalonin nga një dekarki tek tjetra.¹⁵ Në Velletri, sipas burimeve dokumentare, në fundin e shek. XIII hasen dhjetë *boni homines*, gjë që i ka shtyrë studiuesit të mendojnë për një ndarje me pesë dekarki, me popullsi të përgjithshme 4 000-5 000 banorë.¹⁶ Ngjashmërisht edhe në Alatri haset një raport i drejtpërdrejtë

¹⁰ Gottlieb L. F. Tafel, Georg M. Thomas, *Urkunden zur älteren Handels-und Staatsgeschichte der Republik Venedig mit besonderer Beziehung auf Byzanz und die Levante*, II (Wien/Amsterdam: Adolf M. Hakkert, 1856), dok. nr. CLXXXII.

¹¹ Në vitin 1212 shfaqet për herë të parë në Anagni, dhe më pas, nga mesi i shek. XIII te qendrat e tjera. Maria T. Caciorgna, *Marittima medievale* (Roma: Il Calamo, 1996), veçanërisht 191, 216; Lazzaro, “La *decarchia* medievale”, 25, cit. nr. 27; Giorgio Falco, “Il Comune di Velletri nel Medio Evo (sec. XI-XIV)”, në *Studi sulla storia del Lazio nel Medioevo*, 2 vol (*Mischellanea della Società romana di storia patria*, 24) (Roma: Società Romana di Storia Patria, 1988a), 1-393; Giorgio Falco, “I Comuni della Campagna e della Marittima nel Medio Evo”, në *Studi sulla storia del Lazio nel Medioevo*, 2 vol. (*Mischellanea della Società romana di storia patria*, 24) (Roma: Società Romana di Storia Patria, 1988b), 419-690, veçanërisht 427, 529-531.

¹² Lazzaro, “La *decarchia* medievale”, 25.

¹³ Po aty, 24.

¹⁴ Franco Lazzaro, “Alcune note su Velletri medievale, il palazzo comunale e l’assetto urbanistico della città”, *Annali del Lazio Meridionale*, Anno XV/2, n. 30, 2015, 34.

¹⁵ Caciorgna, *Marittima medievale*, 180.

¹⁶ Lazzaro, “La *decarchia* medievale”, 29.

mes numrit të *boni homines* si zyrtarë dhe numrit të dekarkive, ose në Semoneta, ku përjashtohet kështjella.¹⁷

Përdorimi i termit dekarki në shek. XIII është hasur gjithashtu në dokumentet fetare të kishës latine lidhur me territore jashtë zonave të ndikimit bizantin, si në Flandër (përmendur në jetëshkrimin e Shën-Arnoldit).¹⁸ Lidhja me Flandrën duhet parë në kuadrin e titullit “Perandor i Perandorisë Latine të Lindjes”, marrë nga Balduini IX i Flandrës. F. Lazzaro paraqet bindshëm dallimet mes dekarkisë fetare, si ndarje territoriale e dioqezave, dhe dekarkisë së provincave në Italinë e Jugut si ndarje administrative brenda qytetit.

Cila është origjina e dekarkisë në Durrës? Në të dyja rastet e përmendjes së dekarkive, ato lidhen me dy portat kryesore të qytetit. Fakti që njësia ushtarake bizantine e emërtuar dekarki kishte si detyrë edhe kontrollin e hyrjeve në qytet ose vjeljen e taksave doganore, ndoshta e shtyn përdorimin e këtij koncepti herët në kohë. Rëndësia e dy portave në fjalë për qytetin është trajtuar gjerësisht më herët nga ana jonë.¹⁹ Po ashtu, njihet përdorimi si dogana e tyre, megjithëse dokumentet arkivore i takojnë periudhës së administrimit venedikas,²⁰ por kjo duhet marrë si dëshmi e vazhdimit të një tradite më të hershme.

Një tjetër mundësi lidhet me futjen e këtij modeli në Durrës nga Venediku. Republika e Shën Markut shtiu njëkohësisht nën kontroll Korfuzin dhe Durrësin në kohën e Kryqëzatës së Katërt, kur krijoi edhe Dukatin e Durrësit.²¹ Venediku përdori modele të ndryshme qeverisjeje

¹⁷ Po aty, 29.

¹⁸ Jacques P. Migne, *Patrologiae cursus completus, t. CLXXIV, Appendix ad Harrulfum* (Putetiae Parisiorum: 1854), 1471.

¹⁹ Shehi, *Topografia e Durrësit*, 290-296, 303-307.

²⁰ Giuseppe Valentini, *Acta Albaniae Veneta saeculorum XIV et XV, Pars Tertia*, Tomus Vigesimaquartus (Mynih: Rudolfo Trofeniko, 1977) (më tej: AAV XXIV), 6979, viti 1460.

²¹ Me fillimin e kryqëzatës së katërt, Durrësi u dorëzohet forcave sulmuese në vitin 1203. Shih AAlb I, 129-130. Sipas Kenneth M. Setton-it, *The Papacy and the Levant (1204-1571)*, vol. I. *The Thirteenth and Fourteenth Centuries* (Philadelphia: American Philosophical Soc., 1976), 8, Durrësi iu dorëzua doxhës së Venedikut dhe Bonifacit të Montferratit. Që nga ky moment e në vazhdim, qyteti kaloi një periudhë administrimi të paqartë. Në verën e vitit 1205, qyteti u sulmua nga një flotë venedikase dhe u pushtua që në sulmin e parë, praktikisht pa bërë asnjë qëndresë. Venedikasit krijuan të ashtuquajturin “Dukati i Durrësit”, emëruan një guvernator dhe më pas u caktua edhe një kryeipeshkëv latin (Alain Ducellier, *La façade maritime de Albanie au Moyen Age: Durazzo et Valona du XIe siècle au XVe siècle*, Institute for Balkan Studies,

për territoret që mori nën kontroll, nga një podesta shumë i fuqishëm në Kostandinopojë, në dekarinë e Korfuzit a në blerjen e ishujve të Egjeut nga qytetarë venedikas.²² Për rrjedhojë, mundet që edhe koncepti i dekarikisë të jetë zbatuar në forma të ndryshme mes këtyre territoreve. Arsyeja e një zbatimi të ndryshëm të modelit dekarik mund të ketë ardhur si pasojë e pranisë së traditës bizantine, që e shihte të lidhur me kontrollin ushtarak e doganor të portave të qytetit. Njëkohësisht Durrësi nuk kishte shtrirjen territoriale të ishullit të Korfuzit (610.9 km²) që të nevojitej kontrolli i territorit fshatar.

Një version i tretë mund të shihet i lidhur me ndikimin fetar në vendosjen e një modeli dekarik sipas sistemit të qyteteve italiane. Por në këtë rast do të duhej të kishim një ndikim shumë të fortë fetar në administrimin e qytetit, i cili në të vërtetë nuk duket se ka ndodhur. Rasti më i qartë i një ndikimi fetar të dobët përkundrejt pushtetit sovran është ai i ipeshkvit Manfred, i cili u lejua të hyjë në Durrës vetëm pasi u përul para doxhës dhe premtoi besnikëri.²³ Për rrjedhojë, ky version duket shumë më pak i mundshëm.

Një tjetër problem lidhet me formën se si funksiononte modeli dekarik në Durrës. Dy dokumentet që përmendin një sistem ndarjeje administrative me dekarik në Durrës u takojnë përkatësisht viteve 1246 dhe 1338.²⁴ Gjatë vitit 1246, Durrësi kontrollohej nga Despotati i Epirit.²⁵ Përmendja e dekarikisë si një fakt juridik i qartë e vendos vitin 1246 si një datë *ante quem* për krijimin e saj. Kjo datë afron në kohë me dukatin venedikas. Mundet që koncepti i dekarikisë të jetë futur, ose ndryshuar në

monograph 117 (Thessalonike: 1981), 128, 130-131; Alain Ducellier, "Albania, Serbia and Bulgaria", në D. Abulafia (ed.), *The New Cambridge Medieval History*. Vol. V, c. 1198-1300 (Cambridge: Cambridge University Press, 1999), 785; Donald M. Nicol, *The Despotate of Epiros* (Oxford: Blackwell, 1957), 18-19.

²² Mario Pozza, *I patti con l'impero latino di Costantinopoli, 1205-1231* (Roma: Viella, 2004), 25.

²³ *Fontes Rerum Austriacarum. Oesterreichische Geschichts-Quellen. Zweite Abtheilung. Diplomataria et Acta*. XIII Band, Wien 1856, 123, 125.

²⁴ Shih citimin 2 dhe 3.

²⁵ Në vitin 1242 flota venedikase sulmoi Durrësin dhe disa porte të tjera, duke i konsideruar si qendra piraterie kundër saj (Ducellier, *La façade maritime*, 167). Përgjatë vitit 1250, Mihali II u detyrua të lejojë përdorim të lirë të Durrësit dhe portit të tij për ushtritë dhe ambasadorët e Despotatit të Nikesë, si dhe të Mbretit Frederik II të Napolit (Nicola Festa, "Le lettere greche di Federigo II", *Archivio Storico Italiano* (më tej: ASI), serie V, vol. 13, nr. 193 (Verona: Casa Editrice Leo S. Olschki, 1894), 15-16; Nicol, *The Despotate of Epiros*, 150).

aplikim, si element territorial në momentin që në Durrës krijohet dukati venedikas. Ajo që nuk njihet është shtrirja e dekarhive dhe forma e funksionimit juridik të tij. Nuk mund të thuhet tani për tani nëse edhe në Durrës dekarhitë u janë dhënë si feud i trashëgueshëm dhjetë fisnikëve venedikas. Të dhënat arkivore për periudhën pas rënies së dukatit, nuk lënë të kuptohet një fakt i tillë. Nga ana tjetër, përdorimi i konceptit dekarhit në dokumentet noteriale na orienton drejt një ndarjeje territoriale dhe organizimi si njësi qytetase të ngjashme me modelin e qyteteve italiane që vareshin nga Papati. Një zbatim i dekarhitë si ndarje territoriale urbane, jo si feud i trashëgueshëm, mund të gjente shpjegim me praninë e një elite të fuqishme vendore, e cila mund të ketë pranuar të hapë dyert e qytetit për Venedikun në shkëmbim të garancive për të ruajtur pozicionin e tyre. Përgjatë historisë së qytetit përmendet herë pas here kjo elitë në mbështetje të pretendentëve të ndryshëm për të marrë nën kontroll Durrësin.²⁶ Vendosija e sistemit dekarhit, ose ndryshimi i modelit më të hershëm të qeverisjes lokale, mund të ketë qenë një rrugë e ndjekur nga ana e Venedikut për të arritur synimet e veta, duke mos u përballur me rezistencën lokale. Në këtë formë do të arrihej nga njëra anë zyrtarizimi i pozicionit të elitës durrsake në zbatim të ndonjë marrëveshjeje të mundshme, dhe nga ana tjetër, krijimi i mundësisë për të futur në administrimin vendor besnikët venedikas. Ndërkohë vazhdimi i përdorimit të modelit dekarhit të ndarjes territoriale, tregon se e ka tejkaluar jetëgjatësinë e dukatit venedikas të Durrësit. Ky fakt, duhet marrë si një dëshmi e vendosjes së modelit të administrimit urban me *boni homines*, ku bënin pjesë elitat vendore. Nëse do të kishim pasur ndarjen në feude për venedikasit, sistemi do të kishte rënë bashkë me Dukatin e Durrësit. Mendohet se kanë qenë fisnikët vendës që e kanë pëlqyer modelin e administrimit në bazë të dekarhitë dhe e kanë mbajtur në jetë për një kohë të gjatë pikërisht sepse u interesonte.

Të dhënat e renditura deri më tani na tregojnë se përputhja mes emrave të dy dekarhive me portat e qytetit dhe me funksionin e njërive ushtarake bizantine, mund të jenë tregues i një historie më të gjatë sesa dukati venedikas i Durrësit. Përgjatë administrimit bizantin të qytetit, ndoshta kanë ekzistuar dy njësi ushtarake që ruanin këto dy porta të Durrësit, por thjesht në aspektin ushtarak dhe jo si formë organizimi njësie territoriale. Me krijimin e dukatit venedikas, termi mund të ketë

²⁶ Shih Shehi, *Topografia e Durrësit*, 53-100.

pësuar ndryshime dhe ka marrë vlerën e një ndarjeje territoriale brenda qytetit. Deri në identifikimin e të dhënave të tjera ndihmëse, mbetet të mendojmë për një model të ndryshëm të aplikimit në Durrës të sistemit dekarkik, dhe jo nën pronësinë feudale të dhjetë venedikasve si në rastin e Korfuzit.²⁷ Ndarja territoriale e Durrësit në dekarki duhet të ketë funksionuar si një model administrativ, ku qytetarët përzgjidhnin përfaqësuesit e tyre - *boni homines* - ngjashmërisht me versionin italian. Një elitë e tillë politike dhe ekonomike në qytet, që vendoste për fatin e të gjithë banorëve, njihet në Durrës që në shek. X.²⁸ Me sistemin dekarkik kjo elitë mund të ketë gjetur modelin e përshtatshëm të qeverisjes dhe zyrtarizimit të pozicionit të tyre.

Në vitin 1338, kur haset dokumenti i dytë i një dekarkie në Durrës, qyteti ishte tashmë nën administrimin anzhuin.²⁹ Fakti që, me gjithë ndryshimet e fuqive që e kontrollonin qytetin ndër dekada hasim të njëjtin sistem identifikimi dhe organizimi të territorit përgjatë afro 100 vjetëve, dëshmon për një vazhdimësi të formës së brendshme të administrimit vendor. Për rrjedhojë, forma e brendshme e administrimit, me fisnikë vendës të zgjedhur si përfaqësues të dekarkive qytetare, e cila duhet të lidhet me konceptin e komunës qytetare, pavarësisht ndryshimeve të pushtetit sovran, vazhdonte të ishte funksionale dhe të drejtonte jetën e përditshme të qytetit.

Ndërkohë nuk kemi asnjë dokument që të na japë të dhëna të drejtpërdrejta mbi numrin e dekarkive në Durrës dhe modelin përfaqësues të tyre, të ngjashëm me modelin e qyteteve italiane. Jemi të detyruar që të

²⁷ Pozza, *I patti con l'impero latino*, 50-51.

²⁸ Shih Shehi, *Topografia e Durrësit*, 56-57.

²⁹ Nga viti 1332 deri në vitin 1336, qyteti ka njohur sovranitetin anzhuin dhe duket duhet të ketë qenë nën administrimin e drejtpërdrejtë të tyre, nëpërmjet një kapiteni ose vikari. Për vitin 1333 dhe 1334 njohim dokumente që mbajnë vulën e Mbretit Robert, në lidhje me furnizimet për kështjellën e Durrësit; më 1335 përmenden disa personazhe të administratës mbretërore në Durrës, si dhe dërgohen furnizime; në vitin 1336 Durrësi pushtohet për pak kohë nga Mbreti serb, Stefan Dushani (*AAIb* I, 766-767, 769, 774-775, 779, 787, 791, 805). Me përkrahjen e vendësve, Durrësi kaloi nën kontrollin e Robertit të Sicilisë në të njëjtin vit (*AAIb* I, 673, datë 24 tetor 1321, duket se është datuar gabim dhe i takon vitit 1336, shih Andreas Kiesewetter, "I principi di Taranato e la Grecia (1294-1373)", *Archivio Storico Pugliese* LIV, fasc. I-IV gennajo-dicembre 2001, Bd 54, Società di Storia Patria per la Puglia (Bari: Cressati: 2001), cit. nr. 53; *AAIb* I, 805, datë 19 gusht 1336: Mbreti i Sicilisë, Roberti, u drejtohet banorëve të qytetit dhe dukës së Durrësit për t'i shkëputur nga sundimi i Stefan Dushanit; 808, 810-812, dëshmojnë marrjen nën kontroll të qytetit).

shohim disa dokumente të kohës së administrimit venedikas, të cilat na ofrojnë të dhëna anësore mbi këtë çështje.

Megjithëse Venediku shtiu nën kontroll qytetin e Durrësit dhe vendosi modelin qeverisës me administratorë që duhej të ishin qytetarë venedikas të emëruar, herë pas here gjejmë dokumente ku përmenden përfaqësues lokalë të bashkësisë vendore. Me interes është fakti i përmendjes së këtyre përfaqësuesve në numër çift, që na ngjason me formën e përfaqësimit të secilës dekarki (me nga dy veta) në administrimin e qyteteve italiane.³⁰

Në vitin 1401 kemi një tjetër dokument ku urdhërohet bajliu i qytetit që të mblidhej bashkë me 12 qytetarë, përfaqësues të bashkësisë vendore, për të bërë një vendimmarrje të rëndësishme për Durrësin, pasi dy ambasadorë të qytetit kishin shkuar para Senatit.³¹ Këtë radhë nuk bëhet më fjalë për vetëm dy përfaqësues, si në rastin e vitit 1398, apo si ambasadorë pranë Senatit venedikas, por për 12 qytetarë, përfaqësues të bashkësisë vendore. Pas 99 vjetësh hasim të njëjtën shifër, prej 12 vetash, si përfaqësues të bashkësisë vendore. Bëhet fjalë për një letër dërguar në vitin 1500 Sinjorisë, nënshkruar nga Këshilli i të 12-ve, si përfaqësues të bashkësisë vendore.³²

Më shumë se sa një hamendësim, besoj se jemi para një realiteti ku përfaqësuesit vendorë në një Këshill të 12-ve duhet të shihen si një gjurmë e mbijetuar në kohë nga një Këshill qytetar i viteve kur Durrësi drejtohej si një bashkësi qytetare. Ky Këshill i të 12-ve mendojmë se reflekton modelin italian të funksionimit të dekarkive, me nga 2 përfaqësues për secilën prej tyre. Te Këshilli vendor i bashkësisë duhej të gjendeshin 2 përfaqësues të 6 dekarkive të Durrësit, së paku në kohën më të afërt para kalimit nën Venedikun, që do të justifikonte ruajtjen e

³⁰ Lazzaro, "Alcune note su Velletri", 34; Caciorgna, *Marittima medievale*, 180; Lazzaro, "La *decarchia* medievale", 29.

³¹ Lajos Thalloczy, Constantin Jireček, *Acta et Diplomata res Albaniae Mediae Aetatis Illustrantia*, Annos 344-1343, Vol. II (Vindobona: Typis Adolphi Holzhausen, 1918) (më tej: *AAlb* II), 676; Giuseppe Valentini, *Acta Albaniae Veneta saeculorum XIV et XV, Pars Primae, Tomus Tertius* (Palermo: Typis J. Tosini, 1968) (më tej: *AAV* III), 915: "...debeant conuocare Castellanum et Camerarios nostrus deinde et xij de melioribus ciuibus fidelibus nostris deinde...".

³² Mario Sanuto, *I diarii di Marino Sanuto*, vol. III (Venezia: Tipografia del Commercio di Marco Visentini, MDCCCXXX) (vol. I-LVIII, 1879-1903) (më tej: Sanuto III), 943-944, 19 shtator 1500: "...Subscriptio: *Serenitatis vestrae fidelissimi servitores, consilium XII et universitas civitatis Dyrrachii*".

kujtesës së tyre. Ndërsa vetë sistemi me fuqi vendimmarrëse politike ishte zhdukur zyrtarisht, ideja ka mbijetuar në kujtesën kolektive si model përfaqësimi. Mund të ketë qenë kjo kujtesë që në njëfarë mënyrë ka shtyrë Venedikun të ishte i detyruar të ruante ndikimin qytetar në çështjet e qytetit nëpërmjet 12 *boni homines*.

Rektori – drejtuesi kryesor i bashkësisë qytetare

Fatkeqësisht deri më sot kam arritur të gjej vetëm një dokument që na jep pozicionin kryesor ekzekutiv. Në krye të sistemit vertikal të strukturës administrative ekzekutive dukej se ishte një rektor. Kemi një dokument të tetorit të vitit 1324 ku përmendet *Rectori dyrachij*.³³

Në vitin 1324 nuk është e qartë nëse qyteti ishte nën kontrollin direkt anzhuin apo kishte rimarrë një pozicion autonom.³⁴ Zyrtarisht kontrolli anzhuin i Durrësit, nën Filipin I ka vazhduar deri në dhjetor të vitit 1331.³⁵ Nëse Durrësi do të kishte një qeverisje të pavarur apo

³³ Giusepe Valentini, *Acta Albaniae Veneta saeculorum XIV et XV*, Pars Primae, Tomus Primus (Palermo: Kosephi Tosini: 1967) (më tej: AAVI), 63.

³⁴ Filipin II drejtoi një ekspeditë ushtarake në bregun lindor të Adriatikut në vitin 1321 (Kiesewetter, “I principi di Taranato”, 71). Mbetet e paqartë nëse princi anzhuin ua shkëputi qytetin në këtë moment katalanasve (mundësia më e madhe) (po aty, 71-72), apo ka pasur ndonjë formë vetëqeverisjeje. Symeon Simeonis-i shkruante në vitin 1323 se Durrësi në atë kohë ishte subjekt i vëllait të mbretit të Jerusalemit, tjetër titull për Mbretin Robert, M. Esposito (editor, translator), *Itinerarium Symonis Semeonis ab Hybernia ad Terram Sanctam*, Symon Semeonis first edition (Dublin: Dublin Institute for Advanced Studies, 1960) *Scriptores Latini Hiberniae*, No. 4, 38). Po në këtë vit, më 1323, emërohet një kapiten anzhuin në Durrës (*AAIb* I, 688). Një indulgjencë e vitit 1324 është lëshuar në shtëpinë e argjipeshkvit të Durrësit Matteo (banesa gjendej në Penne, qytezë pranë Peskarës), dhe fratit Francesco, ipeshkëv i Vregen-it, sufraganat i tij (Francesco Mottola, “Le pergamene del Fondo ‘Penne’ dell’Archivio di Stato di Napoli e un vescovo sconosciuto”, *Rivista di storia della Chiesa in Italia*, vol. 68, no. 2 (2014), 465-482). Për rrjedhojë, së paku *de juris*, Durrësi vazhdonte të quhej zotërim i anzhuinëve. Një vit më pas, më 1325, princi tjetër anzhuin Giovanni Gravina (vëllai dhe kundërshtari i Filipit të Tarantos) udhëhoqi një ekspeditë drejt bregdetit shqiptar, duke pushtuar disa qytete. Nuk ka asnjë të dhënë të qartë nëse Durrësi ishte pjesë e këtyre qyteteve të pushtuara ose jo (Pëllumb Xhufi, *Dilemat e Arbërit. Një studim mbi Shqipërinë e shek. XI-XVI* (Tiranë: Pegi, 2006), 171; Kiesewetter, “I principi di Taranato”, 72, cit. nr. 57).

³⁵ Qyteti ka qëndruar nën sovranitetin e Filipit deri në vdekjen e tij, në dhjetor të vitit 1331. Në këtë vit ai ka emëruar një kapiten për Durrësin, ndërsa më 25 dhjetor ia kaloi

autonome nën juridiksionin anzhuin, do të merrte kuptim ekzistenca e një rektori në krye të administratës. Trashëgimtarët anzhuinë të Karlit I nuk kanë arritur të kishin një kontroll tërësor të territorit, aq sa të impononin një administratë ushtarake të emëruar nga sovranit anzhuin në vazhdimësi kohore, si në shek. XII. Për rrjedhojë, jemi të prirë që ta shohim pozicionin e rektorit si figura më e lartë e administratës përgjatë këtyre viteve. Në rastet e dobësimit të kontrollit anzhuin qyteti duhet të ketë zgjedhur një pozicion të tillë. Në rastet e kontrollit të fortë qendror (si në rastet e ekspeditave ushtarake), ky rol i ka kaluar kapitenit anzhuin apo edhe vetë sovranit nëse ishte në krye të ekspeditave ushtarake.

Në lidhje me rektorin si pozicioni më i lartë ekzekutiv në qytet me interes është edhe një tjetër detaj historik. Pas marrjes së Durrësit tërësisht nën kontroll Venediku emëron një rektor në vitin 1392,³⁶ pasuar nga një i dytë³⁷ dhe vetëm më pas kalon zyrtarisht me modelin qeverisës me bajl-kapiten.³⁸ Emërimi i rektorit menjëherë pas vdekjes së Gjergj Topisë, do të gjente shpjegim me natyrshmërinë e krijimit të këtij pozicioni si një traditë e qytetit të Durrësit.

***Topothesia* - tjetër njësi administrimi territorial**

Në një akt noterial të vitit 1258 ku përmendet manastiri i Shën-Teodorit të Ilycetit, haset edhe përdorimi i termit *τοποθεσία* (*topothesia*) e Marenzias.³⁹ Mënyra e përdorimit në kontekst e vendos atë si një njësi administrative territoriale. Dokumenti në fjalë e vendos këtë territor në prapatokën e Durrësit, por vendndodhja e saktë ende nuk është identifikuar. Për ne ka rëndësi përdorimi i termit *topothesia* dhe kuptimi që ai mbarte në modelin administrativ të kontrollit të territorit.

Topothesia vlerësohet nga A. Ducellier si nënndarje e territorit komunal, origjina e të cilit mbetet e panjohur.⁴⁰ Termi përshkruhet si e kundërta (*quae est descriptio loci ficti*) e termit “topographia” (*pro*

trashëgiminë e Durrësit të birit, Robertit (1319/1326-1364). Kiesewetter, “I principi di Taranato”, 75, cit. nr. 64.

³⁶ Giuseppe Valentini, *Acta Albaniae Veneta saeculorum XIV et XV*, Pars Primae, Tomus Secundus (Milano: Typs P.I.M.E., 1968) (më tej: AAV II), 456, datuar 26 tetor 1392 “*Pauli de Canali Castellani et rectoris*”.

³⁷ AAV II 458, Marino Cauchò, emëruar më 14 nëntor 1392.

³⁸ AAV II 479, Francisci Georgio (Zorzi), emëruar më 20 shkurt 1393.

³⁹ AAlb I, 246.

⁴⁰ Ducellier, *La façade maritime*, 196.

descriptio loci veri).⁴¹ Nuk kam arritur të gjej asnjë përshkrim të këtij termi dhe evolucionin kronologjik, por ia kam dalë të identifikoj disa raste kur termi *topothesia* është përdorur si tregues pozicioni në terren. Këto citime ndahen qartësisht në dy periudha të mëdha kronologjike.

Periudha e parë kronologjike lidhet me Antikitetin dhe Antikitetin e Vonë, duke përfshirë rajonet e Azisë së Vogël dhe Egjiptin. Njëri prej tyre i përket një mbishkrimi të gjetur në qytetin Germanicopolis në Bitini (Azi e Vogël), datuar se i përket Antikitetit.⁴² Në një korpus elektronik papirusesh nga Egjipti jepen shtatë raste të tjera, të datuara nga viti 179 deri në vitin 632, për prona bujqësore me ara të kultivuara, territore fermash, toka të kultivuara e të ndara në disa parcela, dhe si përcaktuese e një prone private.⁴³ Në një mbishkrim të gjetur pranë deltës së Nilit në Egjipt, datuar si e Antikitetit të Vonë, termi *topothesia* është përdorur për të emërtuar një fermë.⁴⁴

Për periudhën mesjetare kemi hasur më pak raste të përdorimit të këtij termi. Në qershor të vitit 1309, Perandori Androniku II Paleologu konfirmon një pronë për manastirin e Shën Johanit Prodromos që gjendej në *topothesia ton Platonon*; në gusht të vitit 1310, Perandori Mihal IX Paleologu konfirmon pronësinë dhe privilegjet e manastirit Iberon në malin Athos mbi disa prona që gjendeshin në *topothesian tes Malestes*. Të dyja këto raste gjenden pranë Melnikut, në Bullgarinë Jugperëndimore.⁴⁵ Gjejmë përdorimin e termit në një dokument kalimi pronësie të datuar në dhjetor të vitit 1304, mbi një copë tokë që gjendej në *topothesia (H)Almyros*, pranë manastirit të Saint Paraskeve, në

⁴¹ Egidio Forcellini, Giuseppe Furlanetto, Vincenzo deVit, *Totius Latinitatis Lexicon. Opera et Studio Aegidii Forcellini*, Tomus sextus (Prati: Aldina Edente, 1875), 118, v. Topographia.

⁴² Mehmet Alkan, "A new Late Antique property inscription from the Isaurian city of Germanicopolis recording a landlord by the name of Nikopssianis owner of a *proastion/topothesia*", *Gephyra* 15 (2018), 135.

⁴³ DDBDP transcriptions: sb.6.9461; stud.pal.20.142; p.flor.3.279; bgu.12.2151; sb.20.14199; p.flor.2.148; p.cair.masp.2.67162. *The Duke Databank of Documentary Papyri* (korpus elektronik papirusesh). Online: <http://www.papyri.info/docs/ddbdp>

⁴⁴ Friedrich Preisigke, *Sammelbuch griechischer urkunden aus Ägypten*, vol. I (Strassburg: K. J. Trübner, 1915), nr. 5701.

⁴⁵ Mihailo St. Popović, "Die Siedlungsstruktur der Region Melnik in Spätbyzantinischer und Osmanischer Zeit", *Receuil des travaux de l'Institut d'Études Byzantines* XLVII (2010), 254.

Selanik.⁴⁶ Në Greqinë Veriore, pranë fshatit Melenikitsi (on), burimet mesjetare të shek. XIV përmendin një copë tokë të gjendur në *topotheisa Porogion*.⁴⁷ Në një rast e hasim të përdorur edhe brenda perimetrit të madh të mureve të Kostantinopolit. Në një dokument të tetorit të vitit 1351 është shënuar *topotheisa tou Phanariou*, e cila gjendej në juglindje të portës së Kynego-s dhe Saint Johan Prodromo-s, për të treguar prona të një manastiri.⁴⁸

Studiuesi Mehmet Alkan ka dalë në përfundimin se termi *topotheisa* ishte tregues topografik për një zonë me tokë të kultivuar.⁴⁹ Duke pasur parasysh përdorimin në kontekstin tonë, duhet menduar një situatë e ngjashme, për një term me origjinë që nga Antikiteti i Vonë më së paku, që tregonte një territor bujqësor të kultivuar. Por kontrolli i prapatokës nga vetë qyteti ka ndryshuar sipas periudhave historike. Vetëm kur Durrësi ishte nën kontrollin e një pushteti sovran të fuqishëm prapatoka nën administrimin e tij zgjerohej konsiderueshëm. Në vitin 1258, kur datohet përdorimi i këtij termi në rastin tonë, Durrësi duket se kalon nga kontrolli i Despotatit të Nikesë nën Manfred Hohenshtaufen-in.⁵⁰ Koncepti i *topotheisa* si njësi e administrimit të prapatokës duhej të kishte lidhje me vetë Durrësin. Por, deri ku arrinte territori që ishte nën

⁴⁶ Paul Magdalino, Jean Darrouzès, "Some additions and corrections to the list of Byzantine churches and monasteries in Thessalonica", *Revue des études byzantine*, 35 (1977), 280.

⁴⁷ Peter Soustal, "Melenikitsion, das kleine Melnik bei Serres", *Bulgaria Mediaevalis* 2 (2011), 211.

⁴⁸ Johannes Koder, Martin Hinterberger, Otto Kresten et al, *Das Register des Patriarchats von Konstantinopel*, vol. 3, 66 (no. 184) (Vienna: Verlag der Österreichischen Akademie der Wissenschaften, 2001).

⁴⁹ Alkan, "A new Late Antique property", 140.

⁵⁰ Situata në vitet 1258-1259 është e ngatërruar dhe me interpretime të ndryshme. Në një rivlerësim të ngjarjeve, botuar së fundmi nga B. Osswald, despoti i Epirit, Mihal, ka organizuar një sërë aleancash kundër Despotatit të Nikesë me Manfredin, serbët dhe feudalët shqiptarë, të cilët janë hedhur në luftë njëkohësisht. Për rrjedhojë, Durrësi nën kontrollin nikesas është sulmuar e pushtuar nga Manfredi në shkurt të vitit 1257 (Brendan Osswald, "Trois notes sur l'histoire de Durazzo (Durrës) au XIII^e siècle", *Mélanges de l'École française de Rome – Moyen Âge*, 133-1 (2021), 140-150). Sipas G. Pahimerit, në Durrës nuk kishte "as peshkop, as qeveritar e as ndonjë repart ushtarak" (Albert Failler, Vitalien Laurent (përkth.), *Georges Pachymère. Relation Historiques*, vol. I-II (Paris: Les Belles Lettres, 1984) (më tej: Pachymeris I), 10), çka e ka shtyrë P. Xhufin të vlerësojë se qyteti ka qenë nën kontrollin e kryengritësve dhe këta kanë thirrur Manfred Hohenshtaufen-in për të marrë zotërimin e qytetit (Xhufi, *Dilemat e Arbërit*, 99).

modelin e administrimit me *topothesia* pranë qytetit dhe ku zëvendësohej nga dearkia, nuk jemi ende në gjendje ta themi. Për më tepër, siç e tregojnë edhe shembujt mesjetarë që përmendëm, bëhet fjalë për një traditë të lidhur me Perandorinë Bizantine. Për rrjedhojë, me kalimin e kontrollit të prapatokës nën administrimin e fuqive perëndimore, mendojmë se tradita e identifikimit dhe e administrimit të territorit të prapatokës rurale të qytetit me hapësira të kufizuara qartë mes tyre e të njohura si *topothesia* ka humbur. Një arsyetim i tillë do të shpjegonte shumë mirë se përse nuk është hasur më pas i njëjti term në dokumente më të vona kohore.

Evoluimi i administratës qytetase nën Topiajt dhe Venedikun

Të dhënat e renditura më lart na krijojnë një ide të mjegullt mbi formën e funksionimit të bashkësisë qytetare të Durrësit. Praktikisht kemi një ndarje në pushtetin ekzekutiv (rektori dhe zyrtarë të tjerë që nuk përmenden) dhe ai legjislativ (Këshilli i të 12-ve). Struktura ushtarake nuk njihet ende. Përmendja e një modeli qeverisës lokal, paralel me kontrollin nëpërmjet një kapiteni anzhuin përmendet herë pas here në burimet dokumentare.⁵¹ Ky model kishte krijuar një traditë që ruhej me besnikëri nga durrsakët, aq sa haset edhe në dokumente, si “*usu et consuetudines (libertates)*”.⁵²

Mungesa e përmendjes së dearkive në burimet arkivore venedikase, të cilat janë shumë të pasura, na tregon se momenti i kalimit nën administrimin e Republikës së Shën-Markut, në tetor të vitit 1392, mund të merret si kufiri i fundit kohor për përdorimin e strukturës administrative të bashkësisë qytetare. Ndërsa periudha nga viti 1338, kur kemi përmendjen e dytë të dearkisë, deri në vitin e kalimit të Durrësit nën kontrollin venedikas mbetet ende e panjohur, pasi nuk ka të dhëna të sigurta për të thënë nëse ka vazhduar ose jo ky model. Në vazhdim do të përpiqemi të shohim se si e kanë qeverisur Topiajt Durrësin.

Vazhdimësia apo jo e Këshillit qytetar si përfaqësues të dearkive, që nënkupton banorët e qytetit, lidhet drejtpërdrejt me formën e pushtetit sovran në qytet. Nga viti 1338 deri në vitin 1392, qyteti ka njohur momente autonomie ose varësie zyrtare ndaj zotërve të fuqishëm. Në

⁵¹ *AAIb* I, 695, 743.

⁵² *AAIb* I, 258, 561.

vitet kur njihte vetëm zyrtarisht juridiksionin e një pushteti sovran, Durrësi qeverisej si bashkësi qytetare. Përgjatë disa vjetëve ka qenë nën varësinë juridike anzhvine. Në dokumentet anzhvine të këtyre viteve kemi vërejtur se sovranit u drejtohet herë pas here kapitenëve anzhvinë dhe bashkësisë qytetare.⁵³ Ky element duhet të merret si dëshmi e mbijetesës së një përfaqësie qytetare në rolin e një këshilli të qytetit, gjë që duhet të shihet e lidhur me vazhdimin e funksionimit të modelit dekarrik të ndarjes së territorit. Ndoshta te termi *commune* mund të shohim pikërisht një këshill të tillë të përfaqësuesve të qytetit. Ndërsa prania e kapitenëve anzhvinë tregon se ata kishin zëvendësuar rektorin në pozicionin qendror të drejtimit të qytetit. Ky zëvendësim duhet të lidhet gjithmonë me formën e ndikimit të pushtetit të sovranit ndaj qytetit. Kur kontrolli ishte mjaftueshëm i fortë, përfaqësuesi i emëruar zëvendësonte rektorin (kapiten, vikar). Kur ky kontroll ishte vetëm *de jure*, qyteti duhej të ishte nën një drejtues ekzekutiv të zgjedhur ndër përfaqësuesit vendës, pikërisht rektori.

Ndryshime të rëndësishme duhet të kenë ndodhur në strukturën qeverisëse të qytetit të Durrësit me ardhjen e Topiajve si pushtet sovran. Fakti më i qartë për një ndryshim të tillë lidhet me informacionin e përmendur në vitin 1398, ku thuhej se komuniteti durrsak kishte fshehur statutet e tij në manastirin françeskan nga frika e Karl Topisë.⁵⁴ Një veprim i tillë, dhe nxjerrja e tyre vetëm pas kalimit të qytetit nën Venedikun është tregues i qartë i raporteve të këqija mes komunës dhe Topiajve.

Dokumentet që përmendin struktura qeverisëse të Durrësit nën Topiajt janë të pakta. Deri më sot njihen kryesisht në lidhje me modelin ushtarak të kontrollit të territorit. Vetëm në një rast kemi të dhëna për praninë e një strukture civile.

Përveç Karl dhe Gjergj Topisë, përmendet oborri i tyre e baronët e fuqishëm,⁵⁵ që kishin pozicione të rëndësishme, p.sh. si kështjellarë. Kemi hasur deri më sot pak dokumente venedikase që përmendin të tilla aspekte. Në të gjitha rastet bëhet fjalë për shpërbleja që Venediku jepte

⁵³ *AAlb I*, 568, 574-576, 584. Ngjashmërisht edhe disa letra të Raguzës u dërgohen kapitenit, komunës dhe njerëzve të Durrësit (*capitaneus, commune et homines Durachii*), *AAlb I*, 761; *AAlb II*, 179.

⁵⁴ *AAlb II*, 610.

⁵⁵ *AAV II*, 373, 451; Riccardo Predelli, *I libri commemoriali della Repubblica di Venezia, Regestri*, vol. 4 (Cambridge: Cambridge University Press, 2012), nr. dok. 316 (198).

ndaj fisnikëve, pjesë e oborrit të Gjergj Topisë, që kanë ndihmuar në marrjen nën kontroll të Durrësit. Praktikisht te këto dokumente kemi pagesën për blerjen e tyre dhe për shërbimet e kryera për Venedikun. Nuk mund të përdorim termin “tradhti”, pasi këta fisnikë nuk gjendeshin përballë një mundësie të dytë, që mund të ishte një trashëgimtar i Topiajve, apo një tjetër feudal i fuqishëm që dëshironte Durrësin (siç ish in p.sh. Balshajt disa vjet më parë).

Nga këto dokumente njohim një listë të shkurtër të personazheve kyç në oborrin e Gjergj Topisë: Tanush Topia (Thanussius Tobia), Guren Skura (Gurenus Schuto/Schuro, kapiten), Zotëri Burila (Borille voyvoda; dominus Burila), Andrea Muzaka (Andreas Misachi/Musachi, komestabël), Progon Skura (Progonus Scuro), Comini Shpata (Comini Spata, e paqartë nëse *comini* është emër, apo si dy rastet në vazhdim kur jepet si titull), Comini/Konti Niketa (Comiti/comes Nicheta, ndoshta Niketë Topia që haset në disa dokumente venedikase, si zot i Krujës dhe i Kalasë së Turrës), Mark (?) Skura (Marchia Scura), Progon Sakati (?) (Progano Sachato), comiti Guoro, Inklet shqiptari (Inclechi Albanensis, kështjellar i kështjellës së sipërme), Alexius Ricardo di Marno (komestabël).⁵⁶ Dokumenti tjetër lidhet me rëndësinë që luante kleri në qytet edhe përgjatë periudhës së administrimit nga Topiajt dhe personazhet fetare ishin peshkopi Dhimitër (episcopi Dimitri) dhe frati Andrea Nesta (Andreas Nesta).⁵⁷

Fatkeqësisht vetëm në katër raste përmendet pozicioni i personazheve që marrin provizione vjetore nga ana e Venedikut. Bëhet fjalë për: Gurenus Schuto/Schuro, kapiten; Inklet shqiptarin, kështjellar i kështjellës së sipërme; Andrea Muzaka, komestabël; Alessio di Ricardo Dimarno, komestabël.

Këto pozicione janë të njëjta me modelin ushtarak të kontrollit të fortifikimeve dhe forcave ushtarake që haset në Durrës pas kalimit nën pushtetin sovran venedikas. Një element i tillë dëshmon se, struktura ushtarake ishte e ngjashme me modelet perëndimore. Mundet që i njëjti model i strukturës ushtarake të ishte në përdorim më herët, përgjatë viteve të bashkësisë qytetare. Fakti që nuk përmenden duhet marrë si tregues i mbajtjes nën kontroll të ushtrisë nga administrata civile, përkatësisht rektori dhe Këshilli qytetar. Pushteti i drejtuesve ushtarakë

⁵⁶ *AAIb* II, 439, 496-497.

⁵⁷ *AAV* II, 489; *AAIb* II, 496.

qartësisht ka njohur rritje nën Topiajt, përderisa Inklet shqiptari ka ngritur flamurin e Shën Markut në kështjellën e sipërme, me iniciativën e vet. Ky element është tregues i qartë se nën Topiajt ishin eliminuar dy nivelet e administratës civile të komunës qytetare. Me vdekjen e sovranit (në rastin konkret me lëngimin në shtrat të Gjergj Topisë), praktikisht humbiste e vetmja fuqi vertikale që mbante nën kontroll kështjellarin. Në pozicionin e kontrolluesit të njëres prej njërive kryesore ushtarake të garnizonit të qytetit, ai ndihej mjaftueshëm i fuqishëm për të ndërmarrë një veprim të tillë politik (sigurisht në bashkërendim me bujarët e tjerë të përmendur në dokumente).

Qeverisja civile është lënë pothuaj tërësisht në hije në dokumentet arkivore të viteve nën Topiajt. Kemi hasur një dokument i cili përmend pozicionin e *protovestiaris*-it, mbajtur nga Philipp Barelli në vitin 1392,⁵⁸ pozicion ky i ardhur nga tradita bizantine.

Jemi të mendimit se përgjatë qeverisjes së Topiajve duhet të ketë ndodhur një krasitje e sistemit qeverisës komunal të Durrësit. Ndërsa për mbarëvajtjen e punëve të përditshme civile e ligjore ishte e nevojshme të funksiononin pozicionet e zyrtarëve të ndryshëm, janë eliminuar postet drejtuese ekzekutive. Pushteti ekzekutiv duhej të ishte përqendruar te një grup njerëzish pranë feudalit, që kishin edhe pozicione ushtarake dhe kishin zëvendësuar *boni homines*. Kështu do të gjente shpjegim mungesa e përmendjes së komunitetit durrsak te dokumentet venedikase përgjatë raporteve diplomatike me Topiajt, ndryshe nga dokumentet më të hershme anzhuine, ku elita vendore përmendet për gati çdo ngjarje të rëndësishme dhe vendimmarrëse. Ky ndryshim i strukturës qeverisëse të qytetit duhet parë si një përballje mes dy grupimeve të ndryshme, *boni homines* qytetas përkundrejt feudalëve të prapatokës, përfaqësues të të cilëve ishin Topiajt.

Me kalimin e Durrësit nën administrimin venedikas, përdorimi i sistemit të administrimit me qeveritarë të zgjedhur nga Venediku në pozicione të ndryshme ka vulosur përfundimisht eliminimin e sistemit komunal të drejtimit politik të qytetit. Duke filluar që nga bajl-kapiteni, si administratori më i lartë, dhe të gjithë të tjerët me radhë, të cilët duhej të ishin detyrimisht qytetarë venedikas, kishin një ndarje detyrash mes tyre, sa civile, aq edhe ushtarake, që kufizonte edhe kompetencat e ushtrimit të pushtetit që kishte secili. Një fakt i tillë dëshmohej nga aktet noteriale, ku

⁵⁸ AAV II, 431.

nuk hasim më përmendjen e dekarkisë për të identifikuar zonat në të cilat gjendeshin pronat në shitje ose për dhurim.⁵⁹ Një akt noterial edhe më domethënës është ai i vitit 1427. Prona në fjalë gjendej pranë Portës së Detit, por tashmë ky territor nuk emërtohet më si dekarki - ai thjesht identifikohet “*in paragio*”.⁶⁰ Vetë Porta e Detit vazhdonte të ruante në kujtesën kolektive pozicionin e rëndësishëm dhe të mirëdallueshëm që kishte pasur edhe në periudhën e ndarjes në dekarki, vetëm se sistemi kishte ndryshuar tashmë. Duke eliminuar termin dekarki dhe duke përmendur vetëm emrin e Portës së Detit, kemi dëshminë më të mirë të modelit të ri të administrimit të territorit, ku kujtesa kolektive ruante tashmë vetëm toponiminë.

Përfundime

Dobësimi i pushtetit qendror bizantin bëri që në Durrës të fillonin të shfaqeshin grupime qytetarësh të fuqishëm ekonomikisht, që dalëngadalë filluan të kishin edhe pushtet politik. Përgjatë historisë së Mesjetës së Hershme e në vazhdim, këto elita lokale janë konsideruar mjaftueshëm të fuqishme saqë patën ndikime deri edhe në përzgjedhjen se cilës fuqi rajonale do t’i hapte dyert qyteti. Me rënien e Perandorisë Bizantine dhe fillimin e ciklit të kalimit nën kontroll sa të njërit pushtet sovran tek tjetri, struktura e brendshme e qeverisjes së qytetit duket se filloi të evoluonte nga modeli bizantin. Ajo u përshtat me realitetin e kohës dhe do të ishte thellësisht nën ndikimin e modeleve perëndimore të një sistemi komunal. Megjithëse nuk njohim shumë detaje nga ky sistem qeverisjeje qytetare, të dhënat e pamjaftueshme na tregojnë se ka kaluar një periudhë jo e paktë kohore deri në ngjizjen tërësore të tij, deri në shfaqjen si një bashkësi qytetare herë autonome e herë tërësisht e pavarur. Deri më sot, mund të flasim për një Këshill qytetar si fuqia kryesore politike, e cila si përfaqësuese e popullsisë duhej të kishte të drejtën të zgjidhte edhe përfaqësuesit e pushtetit ekzekutiv dhe atij ushtarak. Njohim me siguri për momentin vetëm rektorin, si drejtuesin më të lartë

⁵⁹ *Dokumente për Historinë e Shqipërisë të shek. XV*, vëll. I (1400-1405), përgatitur nga Injac Zamputi dhe Luan Malltezi, redaktor përgjegjës Aleks Buda, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Historisë, (Tiranë: 1987), 63, 138-140.

⁶⁰ Giusepe Valentini, *Acta Albaniae Veneta saeculorum XIV et XV*, Pars Secunda, Tomus Decimus Septimus (Mynih: Rodulpho Trofeniko, 1973) (më tej: AAV XVII), 3127 qq.

ekzekutiv. Por duhet të kenë ekzistuar edhe pozicione të tjera të ngjashme me qytetet mesjetare të rajonit, ku më i afërti ishte ai i Shkodrës⁶¹: gjykatës, financierë, noterë, kancelarë, taksidarë etj. Sistemi i mbrojtjes ushtarake duhej të kishte gjithashtu ngjashmëri me modele të tjera rajonale, me kapitenë e kështjellarë. Por dokumentet që njohim, nuk i paraqesin me qartësi ato.

Kalimi nën qeverisjen e Topiajve solli ndryshime të dukshme në sistemin qeverisës qytetas. Pozicionet më të larta ekzekutive duhet të jenë eliminuar, për t'i lënë vend qeverisjes direkte nga feudali. Por kanë vazhduar të funksiononin të gjitha pozicionet e tjera që duhej ta mbanin një qytet funksional. Pushteti ushtarak u kaloi baronëve të prapatokës, besnikë të feudalit, dhe pjesë e oborrit të tij. Me kalimin nën administrimin e Sinjorisë, sistemi qeverisës lokal u përshtat tërësisht me modelin venedikas. Por ka vazhduar të ruhej së paku në konceptin e një përfaqësimi pa fuqi reale një këshill i qytetarëve, që bashkëpunonte me bajliun venedikas për të luajtur rol në çështjet e rëndësishme të mbarëvajtjes së jetës së qytetit.

Bibliografi:

Botime dokumentare:

- Thalloczy, Lajos & Jireček, Constantin. *Acta et Diplomata res Albaniae Mediae Aetatis Illustrantia*, Annos 344-1343. Vol. I. Vindobona: Typis Adolphi Holzhausen, 1913.
- Thalloczy, Lajos & Jireček, Constantin. *Acta et Diplomata res Albaniae Mediae Aetatis Illustrantia*, Annos 344-1343. Vol. II. Vindobona: Typis Adolphi Holzhausen, 1918.
- Valentini, Giuseppe. *Acta Albaniae Veneta saeculorum XIV et XV*. Pars Primae, Tomus Primus. Palermo: Kosephi Tosini, 1967.
- Valentini, Giuseppe. *Acta Albaniae Veneta saeculorum XIV et XV*. Pars Primae, Tomus Secundus. Milano: Typs P.I.M.E., 1968.
- Valentini, Giuseppe. *Acta Albaniae Veneta saeculorum XIV et XV*. Pars Primae, Tomus Tertius. Palermo: 1968.
- Valentini, Giuseppe. *Acta Albaniae Veneta saeculorum XIV et XV*. Pars Secunda, Tomus Decimus Septimus. Rodulpho Trofeniko. Mynih: 1973.

⁶¹ Lucia Nadin (ed.), *Statuti di Scutari della prima metà del secolo XIV con le addizioni fino al 1469* (Roma: Viella, 2002), 193-194, 197-198, 200, 204, 212-213.

Valentini, Giuseppe. *Acta Albaniae Veneta saeculorum XIV et XV. Pars Tertia, Tomus Vigesimusquartus*. Rudolfo Trofeniko. Mynih: 1977.

Literaturë historiografike:

Abulafia, David. "The Italian South", në M. Jones (bot.), *The New Cambridge Medieval History*. Vol. VI, c. 1300-1415. Cambridge: Cambridge University Press, 2006.

Alkan, Mehmet. "A new Late Antique property inscription from the Isaurian city of Germanicopolis recording a landlord by the name of Nikopssianis owner of a *proastion/topothesis*". In *Gephyra 15*, 2018.

Asdracha, Catherine & Asdrachas, Spyros. "Les paysans dans les fiefs de Corfou: XIVe-XVe siècle". In *Eupsychia: Mélanges offerts à Hélène Ahrweiler*. Paris: 1998.

Barone, Nicola. *Notizie storiche tratte dai registri di cancelleria di re Carlo III di Durazzo*. Naples: 1887.

Bozhori, Koço & Liço, Filip. *Burime tregimtare bizantine për historinë e Shqipërisë, shek. X-XV*. Tiranë: Mihal Duri, 1975.

Breccia, Gastone & Rigo, Antonio. "Una carta privata greca da Durazzo (giugno 1338)". In *Albania. Immagini e documenti dalla Biblioteca Nazionale Marciana e dalle collezioni del Museo Correr di Venezia*. Tirana: Istituto Italiano di Cultura, 1998.

Buda, Aleks & Zamputi, Injac & Mallezi, Luan (botues). *Dokumente të shekujve XVI-XVII për historinë e Shqipërisë të shek. XV (1400-1405)*, vëll. I. Tiranë: Instituti i Historisë, 1987.

Caciorgna, Maria Teresa. *Marittima medievale*. Roma: Il Calamo, 1996.

Ducellier, Alain. *La façade maritime de Albanie au Moyen Age: Durazzo et Valona du XIe siècle au XVe siècle*. Institute for Balkan Studies, monograph 117. Thessalonike: 1981.

Ducellier, Alain. "Albania, Serbia and Bulgaria". In D. Abulafia (bot.), *The New Cambridge Medieval History*. Vol. V, c. 1198-1300. Cambridge: Cambridge University Press, 1999.

Falco, Giorgio. "Il Comune di Velletri nel Medio Evo (sec. XI-XIV)". In *Studi sulla storia del Lazio nel Medioevo*. 2 vol. (*Mischellanea della Società romana di storia patria*, 24). Roma: Stocietà Romana di Storia Patria, 1988a.

Falco, Giorgio. "I Comuni della Campagna e della Marittima nel Medio Evo". In *Studi sulla storia del Lazio nel Medioevo*, 2 vol. (*Mischellanea della Società romana di storia patria*, 24). Roma: Stocietà Romana di Storia Patria, 1988b.

- Festa, Nicola. "Le lettere greche di Federigo II". In *ASI*, serie V, vol. 13, nr. 193, 1894.
- Fontes Rerum Austriacarum. Oesterreichische Geschichts-Quellen. Zweite Abtheilung. Diplomataria et Acta.* XIII Band. Wien: 1856.
- Kiesewetter, Andreas. "I principi di Taranato e la Grecia (1294-1373)". In *ASP* LIV, fasc.I-IV gennaio-dicembre 2001.
- Kiesewetter, Andreas. "L'acquisto e l'occupazione del litorale meridionale dell'Albania da parte di Carlo I d'Angiò (1279-1283)". *Palaver* 4, nr. 1, 2015.
- Koder, Johannes & Hinterberger, Martin; Kresten Otto, et al, *Das Register des Patriarchats von Konstantinopel.* vol. 3, 66 (no. 184). Vienna: 2001.
- Lazzaro, Franco. "La *decarchia* medievale, innovazione o persistenza?". In *Annali del Lazio Meridionale*, Anno IX/2, no. 30, 2009.
- Lazzaro, Franco. "Alcune note su Velletri medievale, il palazzo comunale e l'assetto urbanistico della città". In *Annali del Lazio Meridionale*, Anno XV/2, no. 30, 2015.
- Magdalino, Paul & Darrouzès, Jean. "Some additions and corrections to the list of Byzantine churches and monasteries in Thessalonica". In *Revue des études byzantine*, 35, 1977.
- Migne, Jacques Paul. *Patrologiae cursus completus*, t. CLXXIV, Appendix ad Harrulfum. Putetiae Parisiorum: 1854.
- Mottola, Francesco. "Le pergamene del Fondo 'Penne' dell'Archivio di Stato di Napoli e un vescovo sconosciuto". In *Rivista di storia della Chiesa in Italia*, vol. 68, no. 2, 2014.
- Nadin, Lucia (bot.). *Statuti di Scutari della prima metà del secolo XIV con le addizioni fino al 1469.* Roma: Viella, 2002.
- Nicol, Donald MacGillivray. *The Despotate of Epiros.* Oxford: Blackwell, 1957.
- Osswald, Brendan. "Trois notes sur l'histoire de Durazzo (Durrës) au XIII^e siècle". In *Mélanges de l'École française de Rome – Moyen Âge*, 133-1, 2021.
- Albert Failler, Vitalien Laurent (përkthyen). *Georges Pachymérè. Relation Historiques*, vol. I-II. Paris: Les Belles Lettres, 1984.
- Paradisi, Bruno. "Decarchia bizantina e decena longobarda". In *Studi di Storia e Diritto in onore di Federico Besta*, vol. II. Milano: A. Giufré, 1939.
- Popović, Mihailo St. "Die Siedlungsstruktur der Region Melnik in Spätbyzantinischer und Osmanischer Zeit". In *Receuil des travaux de l'Institut d' Études Byzantines*, XLVII, 2010.

- Pozza, Marco. *I patti con l'impero latino di Costantinopoli, 1205-1231*. Roma: Viella, 2004.
- Predelli, Riccardo. *I libri commemoriali della Repubblica di Venezia, Regestri*, vol. 4. Cambridge: Cambridge University Press, 2012.
- Preisigke, Friedrich (ed.). *Sammelbuch griechischer urkunden aus Ägypten*, vol. I. Strassburg: K. J. Trübner, 1915.
- Sanuto, Mario. *I diarii di Marino Sanuto*, vol. I-LVIII, 1879-1903.
- Setton, Kenneth M. *The Papacy and the Levant (1204-1571)*, vol. I. The Thirteenth and Fourteenth Centuries. Philadelphia: American Philosophical Soc., 1976.
- Soustal, Peter. "Melenikition, das kleine Melnik bei Serres". In *Bulgaria Mediaevalis* 2, 2011.
- Esposito, Mario (ed.). *Itinerarium Symonis Semeonis ab Hybernia ad Terram Sanctam*. Symon Semeonis first edition. Dublin: Institute for Advanced Studies Dublin (1960). *Scriptores Latini Hiberniae*, no. 4.
- Shehi, Eduard. *Topografia e Durrësit mesjetar*. ASA, Instituti Arkeologjik. Tiranë: Botimet albanologjike, 2022.
- Tafel, Gottlieb Lukas Friedrich & Thomas, Georg Martin. *Urkunden zur älteren Handels- und Staatsgeschichte der Republik Venedig mit besonderer Beziehung auf Byzanz und die Levante*, II. Wien/Amsterdam: Adolf M. Hakkert, 1856.
- Forcellini, Egidio & Giuseppe Furlanetto, Vincenzo deVit. *Totius Latinitatis Lexicon. Opera et Studio Aegidii Forcellini*, tomus sextus. Prati: Aldina Edente, 1875.
- Xhufi, Pëllumb. *Dilemat e Arbërit. Një studim mbi Shqipërinë e shek. XI-XVI*. Tiranë: Pegi, 2006.

Site:

The Duke Databank of Documentary Papyri (DDbDP korpus elektronik papirusesh). Online: <http://www.papyri.info/docs/ddbdp>.
Versioni anglisht në përdorim publik te: CELT-Corpus of Electronic Texts: a project of University College, Cork, Ireland. - <https://celt.ucc.ie/published/T300002-001.html>.

EDUARD SHEHI

Institute of Archaeology / Academy of Sciences of Albania
eduardshehi@hotmail.com

S u m m a r y

SOME ASPECTS OF THE ADMINISTRATIVE STRUCTURE OF DURRËS AS A CIVIC
COMMUNITY AND UNDER THOPIA'S

Aspects of the administrative structure of medieval Durrës are treated here, based on a few archival documents. Two notarial documents of sale prove the operation of the *dekarkia* (1246 and 1338). Their names belongs to the main gates: Rider's Gate and Sea Gate. The identification of properties according to *dekarkia* shows that they were a territorial organization similar to some Italian cities. Two Venetian documents (1401 and 1500) mention a Council of 12, as local representatives, a fossil surviving from the years when Durrës was governed as a Civic Community: 2 representatives for 6 former *dekarkia*. While the decision-making power system itself was gone, the idea has survived in the collective memory.

The term “*topothésia*” is found in a notarial deed of sale (1258). A concept related to the Byzantine tradition, used for agricultural territory. As the control of the hinterland passed under the Western powers, the concept of *topotesia* for the administration of the rural territory was lost.

In October 1324, is mentioned the *Rectori dyrachij* as the head of the executive power. This position was functional when the city was independent or autonomous. When it moved under Anjou control, their captain replaced the Rector.

The Thopia's dynasty changed the governing system. We encounter only three military positions: captain; *castellari*; *comestabel*. One document mentions the *protovestiarus*, of Byzantine tradition, another mentions the local *communita*. We cannot say whether it was a civilian structure of city management or not. Thopias must have kept the lower positions, running the daily affairs, but eliminated the higher positions. Power was concentrated in a group of barons near the faudal. The changes should be seen as a confrontation between the *boni homines* of the city versus the feudal lords of the hinterland. With the passage of Durrës under Venice, the use of the administration system with elected Venetian governors has finally eliminated the municipal system of running the city.

